



Skema e re kombëtare e mbështetjes për fermerët, gati javën e ardhshme

Faqe 2

Rritja e çmimit të naftës godet bujqësinë

Rritja e çmimit të naftës po sjell pasoja negative mbi bujqësinë...

Faqe 4

Zarzatet kthehen në mall luksi, pse po na kushtojnë kaq shtrenjtë

Faqe 11



AGROBIZNESI

FED invest

Rr. "Qemal Stafa", P. 9-katësh, Nr. 70, Kati 2, Pazari i ri, Tiranë.
Tel: +355 4 2 251 910 /911
Email: info@fedinvest.al
kontakt@fedinvest.al
www.fedinvest.al

BOTIM I KËSHILLIT TË AGROBIZNESIT SHQIPTAR
Adresa: Rruga "Mine Peza", Pallati 87/3, Hyrja 1, Kati i parë, Tel/ Fax: 2229445
E-mail: infokash@yahoo.com www.kash.org.al

15-ditëshi i parë i muajit mars 2026 **Viti i shtatëmbëdhjetë i botimit - Nr. 529** Çmimi 125 lekë E përdyjavshme e pavarur

CILËSIA SI MOTOR I KONKURRUESHMËRISË

FORCIMI I KONKURRENCËS SË NVM-VE: ROLI I STANDARDEVE DHE CERTIFIKIMEVE NË SEKTORIN E BIMËVE MJEKËSORE DHE AROMATIKE (BAM)

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), përmes Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP), të mbështetur nga Qeveria Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), po mbështet fermerët dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme (NVM) në përmbushjen e standardeve të kërkuara, duke lehtësuar aksesin e tyre në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare

GQSP ALBANIA
GLOBAL QUALITY AND STANDARDS PROGRAMME

Programi Global Për Cilësi dhe Standarde

UNIDO
UNITED NATIONS INDUSTRIAL DEVELOPMENT ORGANIZATION

Schweizerische Eidgenossenschaft
Confédération suisse
Confederazione Svizzera
Confederaziun svizra

Sekretariati i Shtetit për Çështjet Ekonomike SECO



Programi i BSH për SME-të, në 2025-n u shfrytëzua më pak se 7% e shumës në dispozicion

Faqe 6

MJEDIS

Mbrojtja e natyrës, prioritet për Shqipërinë dhe BE, Gonzato: Veprime konkrete përtej përafrimit të politikave

Faqe 7

MIKROFINANCË

FED Invest dhe ABA Online trajnim për bletarët në Elbasan

Faqe 5

TEMA TË DITËS

- Mbi 600 mijë koshere bletë në 2025-ën, synimi 1 milion deri në 2027-ën Fq.2
- Të rinjtë do të mbështeten me 7-10 mijë euro për zhvillimin e blegtorisë Fq.2
- Matrikullimi i bagëtive në Shkodër - Proces i detyrueshëm për sigurinë dhe skemat e subvencioneve Fq.4
- Falen kamatëvonesat për kontributet e prapambetura - Lehtësimi për fermerët debitorë, nëse kontributet paguhen brenda këtij viti Fq.5
- Kërpudhat në Krahinën e Oparit - Prof. As. Dr. Eqrem Meçollari Fq.13

FINANCIM

Ibrahimaj: Financim deri në 9 milionë lekë për startup-et, në 2026-ën

Faqe 6

TEMA TË DITËS

Salla: Skema Kombëtare mbështeti mbi 65 mijë fermerë në 2025-ën

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla deklaroi se në vitin 2025 u mbështetën mbi 65 mijë fermerë përmes Skemës Kombëtare të Mbështetjes, duke shpërndarë një fond total prej rreth 5,5 miliardë lekësh.

“Gjatë vitit 2025, Ministria ka akorduar rreth 5,5 miliardë lekë për Skemën Kombëtare të Mbështetjes së Fermerëve, duke mbështetur mbi 65 mijë fermerë në të gjithë vendin. Rezultatet kanë treguar rritje të ndjeshme në disa sektorë të rëndësishëm, sidomos në blegtori dhe bletari”, tha ministri Salla, gjatë seancës dëgjimore në Komisionin për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Ushqimin.

Ministri theksoi se gjatë muajve janar dhe shkurt të këtij viti janë zhvilluar 23 takime dëgjimore në 12 qarqe të Shqipërisë, ku morën pjesë fermerë, blegtorë, bletarë, përpunues dhe përfaqësues të

pushtetit vendor.

Sipas tij, qëllimi i këtyre takimeve ishte mbledhja e in-



formacionit mbi nevojat reale të fermerëve dhe përmirësimi i procedurave në skemat mbështetëse.

Salla shpjegoi se Ministria ka ngritur një grup pune për të shqyrtuar sugjerimet e marra nga fermerët, duke syn-

uar rritjen e pagesave për krerë dhe për koshere bletësh, si dhe thjeshtimin e procedurave ad-

ministrative për përfituesit.

Salla nënvizoi se këto iniciative synojnë që Skema Kombëtare të reflektojë më mirë nevojat e fermerëve dhe të sigurojë mbështetje efektive për zhvillimin e sektorit bujqësor dhe rural në Shqipëri.

Skema e re kombëtare e mbështetjes për fermerët, gati javën e ardhshme

Skema e re kombëtare e mbështetjes për fermerët pritet të finalizohet brenda javës së

gjatë seancës dëgjimore në Komisionin për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Ushqimin,

ret përfundimtar.

Salla theksoi se një nga shtyllat kryesore të skemës së re do të jetë formalizimi i sektorit bujqësor, përmes mekanizmit të rimbursimit 10% të autofaturave për çdo faturë të depozituar pranë autoriteteve tatimore.

Ministri bëri të ditur se po shqyrtohet hapja e një mase të re mbështetjeje për sektorin e akuakulturës, përveç mbështetjes ekzistuese për peshkimin.

Ndërkohë, në paketën e parë të investimeve me grant 50%, mbi 800 projekte janë paraqitur pranë AZHBR-së, me një buxhet rreth 3 miliardë lekë.

“Lista e re e përfituesve pritet të publikohet në ditët në vijim, ndërsa aplikantët që nuk do të përfitojnë do të kenë mundësi të përfshihen në skemën e re”, tha Salla.



ardhshme, pas përfundimit të procesit të konsultimeve me fermerët në të gjithë vendin.

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla,

deklaroi se skema po hartohet mbi bazën e informacionit të mbledhur në 23 takime të zhvilluara në terren dhe se shumë shpejt do të dalë rezultati konk-

Të rinjtë do të mbështeten me 7-10 mijë euro për zhvillimin e blegtorisë

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, gjatë seancës dëgjimore në Komisionin për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Ushqimin, deklaroi se sektori i blegtorisë do të marrë mbështetje të shtuar, duke u fokusuar veçanërisht tek të rinjtë.

Salla bëri të ditur se të rinj dhe të reja që shprehin interes për të punuar në këtë sektor do të mbështeten me fonde

prej rreth 7-10 mijë euro për përfitues, në mënyrë që të inkurajohet rritja e numrit të blegtorëve dhe zhvillimi i sektorit.

“Sa i përket blegtorisë, kemi pasur disa të rinj dhe të reja që në kërkesat e tyre kanë kërkuar të mbështeten në këtë sektor. Ne kemi menduar që në një masë prej 7-10 mijë euro t’i ndihmojmë nëpërmjet sektorit të blegtorisë, në mënyrë që të kemi një rritje të

numrit, por edhe t’u ofrojmë të rinjve një mundësi në këtë sektor që duhet ta rrisim dhe ku duhet të kemi një vëmendje të shtuar për rritjen e numrit të blegtorisë”, tha ministri Salla.

Ai shtoi se kjo iniciativë është diskutuar edhe në komisione dhe me stafin e ministrisë, dhe do të jetë pjesë e planit të përgjithshëm për mbështetjen e sektorit të blegtorisë në të gjithë vendin.

Mbështetja për mbrojtjen biologjike rritet në 70%

Mbështetja për mbrojtjen biologjike në serra pritet të rritet nga 50%, në 70% të vlerës së faturave tatimore, si pjesë e skemës së re kombëtare për fermerët.

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, gjatë seancës dëgjimore në Komisionin për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Ushqimin, deklaroi se kjo masë vjen pas kërkesave të fermerëve dhe synon rritjen e sigurisë ushqimore dhe cilësisë së produkteve bujqësore.

Sipas tij, aktualisht sipërfaqja e serrave me mbrojtje biologjike zë rreth 10% të sipërfaqes totale të mbjelljeve, ndërsa me rritjen e mbështetjes synohet që kjo përqindje të arrijë në 30-40%, duke garantuar kontroll më të madh që nga mb-

jellja deri në daljen e produktit në treg.

se mbështetja do të lidhet me ngushtë me formalizimin dhe



Vetëm gjatë vitit të kaluar, nga serrat në të gjithë vendin janë eksportuar mbi 330 mijë tonë produkte bujqësore.

Ministri theksoi gjithashtu

faturimin, përmes mekanizmit të rimbursimit 10% të autofaturave, me qëllim rritjen e transparencës dhe forcimin e zinxhirit të kontrollit.

Mbi 600 mijë koshere bletë në 2025-ën, synimi 1 milion deri në 2027-ën

Ministri i Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural, Andis Salla, gjatë seancës dëgjimore në Komisionin për Bujqësinë, Zhvillimin Rural dhe Ushqimin, deklaroi se numri i koshereve në Shqipëri ka arritur mbi 600 mijë në vitin 2025, duke u dyfishuar nga rreth 300 mijë në vitin 2020.

Ministri Salla nënvizoi se gjatë takimeve dëgjimore me fermerët, janë mbledhur të gjitha informacionet e nevojshme për të bërë ndryshime në buxhet për të përmbytur kërkesat e fermerëve, veçanërisht në sektorët e bleg-

torisë dhe bletarisë.

“Fermerët na kanë kërkuar që mbështetja për çdo koshere të rritet nga 1000 lekë në 2000 lekë. Ky është një sektor delikat, ku çdo koshere e humbur nuk mund të rikuperohet menjëherë. Mbështetja e shtuar synon të dyfishojë aktivitetin bletar dhe të garantojë që ky sektor jetik të zhvillohet në mënyrë të qëndrueshme”, tha ministri Salla.

Ai shtoi se synimi është që deri në vitin 2027 numri i koshereve të arrijë 1 milion, duke rritur produktivitetin dhe përfitimet për bletarët. Përveç

kësaj, për çdo kilogram të prodhimit të bletëve që shitet, fermerët do të përfitojnë 10% të autofaturave, duke mbyllur një hallkë të rëndësishme të skemës kombëtare mbështetëse.

Ministri theksoi se është ngritur një grup pune për të shqyrtuar të gjitha sugjerimet e marra nga fermerët, duke synuar thjeshtimin e procedurave dhe rritjen e pagesave për përfituesit, në mënyrë që Skema Kombëtare të reflektojë më mirë nevojat reale të sektorit të bletarisë dhe blegtorisë.

Alarm për qepën e Bozhgradit - Fermerët kërkojnë mbështetje për prodhimin vendas

Një nga kulturat më të njohura bujqësore të zonës së Devollit, qepa e Bozhgradit, po përjeton një rënie të sipërfaqeve të mbjella, duke reflektuar vështirësitë me të cilat përballen sot fermerët vendas.

Dikur një ndër burimet kryesore të të ardhurave për shumë familje të fshatit, kjo kulturë po kultivohet gjithnjë e më pak nga viti në vit.

Sipas fermerëve, kostot e rritura të prodhimit, mungesa e një tregu të qëndrueshëm dhe largimi i të rinjve drejt emigracionit kanë ndikuar në uljen e interesit për kultivimin e saj.

Reduktimi i popullsisë dhe mungesa e fuqisë punëtore kanë sjellë vështirësi në përballimin e punëve bujqësore, ndërsa edhe konsumi në tregun vendas ka pësuar rënie.

“Kemi mbjellë qepë prej vitesh, 10 vitet e fundit ka

mbështetje konkrete për të nxitur zhvillimin bujqësor dhe



rënie dhe nuk kemi më prodhim qepe. Janë 5-6 familje që mbjellin”, u shpreh Selman Zorba, Kryetar i fshatit Bozhgrad.

Banorët e zonës kërkojnë

ruajtur traditën për prodhimin vendas. Përveç qepës, banorët merren edhe me kultivimin e drithërave, patates dhe perimeve të ndryshme, si edhe me blegtori në shkallë familjare.

CILËSIA SI MOTOR I KONKURRUESHMËRISË

FORCIMI I KONKURRENCËS SË NVM-VE: ROLI I STANDARDEVE DHE CERTIFIKIMEVE NË SEKTORIN E BIMËVE MJEKËSORE DHE AROMATIKE (BAM)

Organizata e Kombeve të Bashkuara për Zhvillim Industrial (UNIDO), përmes Programit Global për Cilësi dhe Standarde (GQSP), të mbështetur nga Qeveria Zvicerane përmes Sekretariatit Shtetëror për Çështjet Ekonomike (SECO), po mbështet fermerët dhe ndërmarrjet e vogla e të mesme (NVM) në përmbushjen e standardeve të kërkuara, duke lehtësuar aksesin e tyre në tregjet evropiane dhe ndërkombëtare

Ky artikull mbështetet në analizën e detajuar të zinxhirit të vlerës për bimët mjekësore dhe aromatike (BAM) në Shqipëri, të kryer në kuadër të Programit Global për Cilësinë dhe Standardet (GQSP), financuar nga Qeveria Zvicerane dhe zbatuar nga UNIDO. Qasja metodologjike e përdorur përfshin hartëzimin e aktorëve të zinxhirit (prodhues, grumbullues, përpunues, eksportues), analizën e proceseve teknologjike në çdo hallkë, vlerësimin e boshllëqeve të përputhshmërisë me standardet ndërkombëtare dhe identifikimin e barrierave teknike në tregti (TBT). Në këtë kuadër, cilësia nuk trajtohet vetëm si atribut i produktit final, por si një sistem i integruar menaxhimi që fillon nga praktikat bujqësore, vazhdon me proceset e përpunimit dhe përfundon me paketimin, gjurmueshmërinë dhe dokumentacionin e eksportit.

Në aspektin teknik, adoptimi i standardeve ndërkombëtare kërkon implementimin e sistemeve të menaxhimit të dokumentuara, të mbështetura në procedura standarde operimi (SOP), analiza të rrezikut dhe kontroll të pikave kritike (HACCP), si dhe në auditime të brendshme dhe të jashtme nga trupa të akredituara sipas ISO/IEC 17021 dhe ISO/IEC 17065. Për shembull, ISO 9001 kërkon vendosjen e një sistemi të menaxhimit të cilësisë të bazuar në ciklin PDCA (Plan-Do-Check-Act), identifikimin e proceseve kyçe, menaxhimin e rreziqeve dhe përmirësimin e vazhdueshëm. ISO 22000 dhe FSSC 22000 kërkojnë integrimin e programeve paraprake (PRPs), analizën e rreziqeve biologjike, kimike dhe fizike dhe verifikimin sistematik të kontrolleve. GlobalG.A.P. përcakton kërkesa të detajuara për praktikat bujqësore, përfshirë përdorimin e inputeve, menaxhimin e tokës, ujitjes, mbrojtjen e kulturave dhe higjienën e korrisjes, ndërsa BRCGS dhe IFS vendosin kërkesa strikte për kontrollin e proceseve të përpunimit, menaxhimin e alergjenëve, gjurmueshmërinë “një hap përpara – një hap pas” dhe procedurat e tërheqjes së produkteve nga tregu.

Tabela 1. Tabela sinoptike e standardeve kryesore përkatëse ISO dhe private sipas fushëveprimit dhe zhvilluesit

Zhvilluesi/prona	ISO	Lëndët private
Fushëveprimi		
Menaxhimi	Familja ISO 9000 (r. 5), sistemi i menaxhimit të cilësisë	
Siguria e ushqimit	Familja ISO 22000 (rr. 4)	Ato kryesore : FSSC 22000
Zinxhiri i përgjithshëm i furnizimit		
Segmentet e zinxhirit të furnizimit		Ato kryesore : • GlobalG.AP. familja dhe shtesat (prodhimi dhe pas) • LCG-BRCGS (ushqim i përpunuar); • GFSI-IFS (përpunimi i ushqimit);
Kompanitë dhe funksionet e zinxhirit të vlerës	• ISO 27001 (Sistemi i menaxhimit të sigurisë së informacionit); • ISO 28001 (Sistemi i menaxhimit të sigurisë); • ISO 37001 (sistemi i menaxhimit kundër ryshfetit); • ISO 10002 (kënaqësia e klientit); • ISO 22301 (vazhdimësia e biznesit, elasticiteti);	
Qëndrueshmëria	• ISO 45001 (Shëndeti dhe Siguria në Punë); • ISO 14001 (Sistemi i menaxhimit të mjedisit); • ISO 50001 (Menaxhimi i Energjisë).	Mbi 300 VSS; kryesoret : NVMTA, Fairtrade, Rainforest, SA 8000, disa GlobalG.AP . shtesa, panair for Life, BSCI
Vlerat kulturore		• Hallall (të ndryshëm sipas vendit dhe TIC); • Kosher (ndryshe nga TIC).

Një komponent kritik teknik në sektorin BAM është gjurmueshmëria (traceability), e cila kërkon sistem të kodimit të loteve, regjistra prodhimi, evidenca të magazinimit dhe dokumentacion eksporti që lejon identifikimin e origjinës së produktit në çdo moment. Kjo lidhet drejtpërdrejt me kërkesat e BE-së për sigurinë ushqimore dhe për produktet bimore, si dhe me standardet e cilësisë për vajrat esenciale dhe bimët e thata (p.sh. ISO për vajrat esenciale specifike sipas llojit të bimës). Gjithashtu, laboratorët e testimi duhet të jenë të akredituar sipas ISO/IEC 17025 për analiza fiziko-kimike dhe mikrobiologjike, duke përfshirë mbetjet e pesticideve, metalet e rënda dhe parametrat e pastërtisë.

Në dimensionin e qëndrueshmërisë, standardet ISO 14001 dhe ISO 50001 kërkojnë vendosjen e sistemeve për monitorimin e ndikimit mjedisor dhe konsumit të energjisë, ndërsa ISO 45001 kërkon identifikimin dhe minimizimin e rreziqeve për shëndetin dhe sigurinë në punë. Në të njëjtën kohë, Standardet Vullnetare të Qëndrueshmërisë (VSS) si FairWild, Organic (EU Regulation 2018/848) dhe skema të tjera të certifikimit të përgjegjshëm kërkojnë ruajtjen e biodiversitetit, mbledhjen e qëndrueshme nga natyra, respektimin e të drejtave të punëtorëve dhe transparencën në marrëdhëniet tregtare. Këto standarde kërkojnë auditime të thelluara në terren, plane menaxhimi të burimeve natyrore dhe sisteme të raportimit të verifikueshëm.

Të dhënat e mbledhura nga GQSP në Shqipëri tregojnë se megjithëse një pjesë e ndërmarrjeve kanë filluar të implementojnë standarde (28% organike, 20% HACCP, 14% ISO 9001, 10% BRCGS, 6% FSSC 22000), shumica ende operon me sisteme informale ose të pjesshme të menaxhimit të cilësisë. Boshllëqet kryesore teknike lidhen me mungesën e dokumentimit të proceseve, kapacitete të kufizuara laboratorike të akredituara në vend, kosto të larta të certifikimit fillestar dhe mungesë ekspertize të brendshme për mirëmbajtjen e sistemeve të menaxhimit.


Tabela 2 më poshtë përmbledh frekuencën e ndërmarrjeve të certifikuara brenda objektit kampion të vrojtimit në terren. *Është e rëndësishme të nënvizohet se një kompani e vetme mund të mbajë më shumë se një certifikim.*

Tabela 2. Pjesa e ndërmarrjeve të mostrës që mbajnë certifikata të ndryshme

Certifikimin	Pjesa e mostrës
Organike (BiO) USDA Organike ose BioSUISSE	28%
HACCP	20%
ISO 9001:2015	14%
BRCGS	10%
Kosher	10%
FSSC 22000	6%
Aleanca e pyjeve të shiut	2%
Tregti të ndershme	2%
Auditimi Etik i Tregtisë së Anëtarëve të Sedex (NVMTA)	2%
Të tjerët	6%

Burimi: Anketa UNIDO/GQSP 2023

Në përfundim, forcimi i konkurrueshmërisë së sektorit BAM në Shqipëri kërkon një qasje të integruar teknike dhe institucionale: zhvillimin e kapaciteteve të organeve të vlerësimit të konformitetit (TIC), mbështetjen financiare dhe teknike për NVM-të për implementimin e standardeve, harmonizimin e legjislacionit kombëtar me acquis të BE-së dhe krijimin e një sistemi funksional të infrastrukturës së cilësisë që përfshin standardizimin, metrologjinë, akreditimin dhe mbikëqyrjen e tregut. Në këtë kontekst, standardet dhe certifikimet nuk janë thjesht mjete teknike, por përbëjnë bazën e integritit të sektorit në zinxhirët globalë të vlerës dhe një instrument strategjik për zhvillim të qëndrueshëm ekonomik.



Para hapjes së IPARD III, qeveria ndryshon strukturën menaxhuese

Parashikohet që brenda këtij vitit të hapet programi IPARD III për dhënie e fondeve në ndihmë të sektorit të bujqësisë

Para hapjes programit qeveria ka ndryshuar strukturën menaxhuese. Ndryshimet e vendimit "Për ngritjen e strukturave dhe autoriteteve përgjegjëse për menaxhimin indirekt dhe ushtrimin e funksioneve, të përgjegjësisë dhe të marrëdhënieve ndërmjet autoriteteve dhe strukturave të menaxhimit indirekt të asistencës së Bashkimit Evropian, në kuadër të programit për zhvillimin rural të instrumentit për asistencën e paraanëtarësimit (IPARD III)" janë botuar në

Fletoren Zyrtare.

Sipas vendimit të mëparshëm, struktura menaxhuese përbëhej nga organi kontabël dhe zyra mbështetëse e ZKA-së (Zyrtari Kombëtar Autorizues), si struktura të veçanta në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë, nën përgjegjësinë e ZKA-së për zbatimin e programit IPARD III, me ndarje të qartë detyrash sipas vendimit dhe rregulloreve përkatëse.

Me ndryshimin e ri, struktura vazhdon të përbëhet nga

zyra mbështetëse e ZKA-së dhe organi kontabël, por tashmë përcaktohet se ajo do të drejtohet nga drejtori i përgjithshëm i strukturës për menaxhimin e fondeve të Bashkimit Evropian në ministrinë përgjegjëse për financat.

Sipas ndryshimeve, struktura menaxhuese do të vijojë të veprojë nën përgjegjësinë e ZKA-së dhe në përputhje me funksionet e përcaktuara në vendim, si dhe me manualin dhe rregulloren e brendshme të ministrisë.

Matrikullimi i bagëtive në Shkodër - Proces i detyrueshëm për sigurinë dhe skemat e subvencioneve

Teksa na ndajnë vetëm pak ditë nga hapja zyrtare e aplikimeve për skemat mbështetëse,

krahas garantimit të sigurisë është kusht në përfitim të skemave të subvencioneve.

matrikullimi", u shpreh Preçi.

Vitin e shkuar ka pasur fermerë të cilët janë penalizuar nga përfitim i granteve pasi kanë matrikulluar bagëtitë pas aplikimit në këto skema gjë që ka bërë përjashtimin e tyre.

"Vitin e kaluar ka pasur raste që fermer të ndryshëm nuk kanë përfitur mbështetje financiare vetëm prej faktit sepse ato kanë kryer procesin e matrikullimit vetëm mbasi ato kanë kryeraplikimin", u shpreh ai.

Në qarkun Shkodër janë rreth 32 mijë ferma të regjistruara prej të cilave vetëm 18 mijë janë aktive. Identifikimi individual i kafshëve dhe regjistrimi i fermave blegtorale në RUDA, është hapi i parë i formalizimit të sektorit dhe siguron gjurmueshmërinë e shëndetit të kafshëve dhe produkteve me origjinë shtazore.



shërbimi veterinar në Shkodër ka zbritur në terren duke orientuar fermerët në kryerjen e këtij procesi. Sipas përgjegjësit Mark Preçi, matrikullimi i bagëtive

"Ky është një proces i shtrirë gjatë të gjithë vitit, por momentalisht kur jemi në prag të aplikimeve të subvencioneve bëhet edhe më i domosdoshëm

Vaksinimi i bagëtive kundër brucelozës – Në Gjirokastrë, mbi 50 mijë vaksina do të kryhen nga shërbimi veterinar

Në qarkun e Gjirokastrës ka nisur vaksinimi i bagëtive kundër sëmundjes së brucelozës. Shërbimi veterinar ka planifikuar të realizojë mbi 50 mijë vaksina në të gjithë zonën, me qëllim parandalimin e përhapjes së kësaj sëmundjeje tek bagëtitë.

"Po planifikohen të vaksinohen rreth 50 mijë të imëta për sëmundjen e brucelozës e cila është një sëmundje që shkakton dëm në ekonomi dhe shëndetin tek njerëzit", u shpreh Krenar Veliu veterinar.

Autoritetet veterinarë u bëjnë thirrje blegtorëve të bashkëpunojnë me ekipet në terren për realizimin e vaksinimit, në mënyrë që të parandalohet përhapja e sëmundjes dhe të

mbrohet shëndeti publik.

"Dua ti kujtoj fermerët se

Fushata e vaksinimit pritet të përfundojë në javët në vi-



vërtet shteti ka një strategji të caktuar dhe e bën falas vaksinën", tha ai.

jim, duke përfshirë të gjitha zonat blegtorale të qarkut të Gjirokastrës.

Dyfishohet ndihma për bletët, 2 mijë lekë për koshere - Bletarët kërkojnë kullota dhe mjekim të detyrueshëm

Mbështetja financiare për bletërritësit në Skemën Kombëtare 2026 do të dyfishohet, nëse një bletërritës përfitonte 1000 lekë të reja për koshere, këtë vit për të njëjtën familje bletësh do të marrë 2000 lekë te reja

Ky që shihni në ekran është Engjëllush Spaho, prej gati 50 vitesh merret me punët e bletarisë ai thotë se ky sektor nuk ka nevojë vetëm për para nevoja, nevoja më e madhe për njerëzit që rrisin bletë është shtimi i kullotave, e kjo nuk behët vetëm duke pritur natyrë, por duke mbjellë lule që japin nektarin e duhur që bletëve u zgjat jetën dhe u rrit prodhimin e mjaltit.

"Duhet mbjellë kullota me qëllim që bletarët të zhvillojnë bletët sidomos në dy bimë perko dhe facelia, sepse janë bimë që mund të mbillen me periudha të ndryshme. Për shembull kur në natyrë nuk ka lule shumë ato zëvendësojnë dhe ndihmojnë bletën, sepse shpirti i bletës është lulja", tha Spaho.

Ministri i Bujqësisë Andis Salla thotë si ka vënë vetës një qëllim, të arrijë një milion koshere.

Por që pretim të vihet në

jetë më parë specialistët e veterinarisë të drejtuar prej tij duhet të kujdesen për shëndetin e bletës.

E në rastet kur ky rregull nuk respektohet nga të gjithë, do të jetë gjoba ajo që do t'i nënshtrojnë.



"Nëse ne nuk bëjmë mjekim të organizuar për varrotozën atëherë nuk kemi bërë asgjë sepse ashtu si çdo gjallesë edhe varrotoza shkon aty ku ka lirë. Nëse unë i kam mjekuar bletët e mia, ky in-sekt do të shkojë të bletët e pa mjekuara", u shpreh Engjëllush Spaho-bletërritës.

"Nëse ndonjë bletar nuk i mjekon bletët atëherë ai të ndëshkohet dhe të gjobitet", tha ai.

Edhe pse numri i koshereve të bletëve është në rritje, 600 mijë familje nuk mjaftojnë për t'ju përgjigjur kërkesa të tregut të brendshëm me mjaltë.

Rritja e çmimit të naftës godet bujqësinë

Rritja e çmimit të naftës po sjell pasoja negative mbi bujqësinë shqiptare, në periudhën më intensive të saj.

Sipas analizës së fundit të bërë nga ALTAX, nafta ka arritur deri në 179 lekë/litër për shkak të tensioneve

itetin që ka në ekonomi direkt dhe ndërlidhur me sektorë të tjerë. Në bujqësinë në fushë, rritja e çmimeve të naftës rrit kostot për traktorët, makineritë e mbjelljes dhe korjes, si dhe për transportin e prodhimeve në treg. Nga përvoja e krizës

çuar në çmime më të larta për perimet dhe frutat. Ndikimi është më i fortë në serra për shkak të intensitetit energjetic, duke prekur prodhimin sezonal dhe eksportet.

Sektori i përpunimit agroshqimor preket nga rritja e kostove të transportit për lëndët e para (si drithërat apo frutat) dhe energjisë për makineritë e përpunimit (p.sh., mullinj, konservatore). Kjo çon në rritje të çmimeve të produkteve finale si mielli, vaji apo konservat, duke amplifikuar inflacionin ushqimor dhe duke ulur kërkesën nga konsumatorët. Nga përvoja e inflacionit në 2022, kur çmimet e energjisë u rritën, fabrikat e miellit në Shqipëri panë një rritje të kostove me 30%, duke çuar në faliment të vogla dhe rritje të çmimeve të bukës me 20%. Blegtoria & akuakultura po ashtu parashikohet të kenë një rënie me prodhimin deri 25%.

Për këtë arsye ALTAX propozon marrjen e masave të cilat amortizojnë rritjen e çmimeve siç mund të jenë kuponë/rimbursime për naftë bujqësore (20-30% e kostos); Grante për panele diellore në ujëte e serra; Rezerva shtetërore për plehra & fara; Kredi të buta për makineri moderne/hibride; Përmirësim i infrastrukturës rurale.



në Lindjen e Mesme. Dhe si pasojë, llogaritjet rritje e kostos së prodhimit bujqësor me 20-30%. Po ashtu, ALTAX thekson se për shkak të rritjes së kostove të prodhimit, parashikohet ulje e prodhimin me 10-20%, sikurse ndodhi në krizën e Ukrainës ku pati rënie 15% sipas INSTAT, dhe po ashtu shtrenjtohen inputet si plehrat, farat e pesticide.

Analiza e evidenton se së pari, bujqësia në fushë dhe në serra preket më shumë dhe më shpejt nga të tjerat, për masiv-

së Ukrainës, ku çmimi i naftës u dyfishua, fermat shqiptare panë një rritje të kostove të karburantit me 25-40%, duke çuar në ulje të sipërfaqeve të mbjella me drithëra si gruri apo misri, dhe një rënie të prodhimin me 10-15% në zonat si Fieri apo Korça.

Në serra, ku energjia është kritike për ngrohje dhe ujëte (shpesh me pompa që varen nga karburanti ose energjia elektrike e ndikuar indirekt nga nafta), kostot operative rriten ndjeshëm, duke ulur marzhet e fitimit dhe duke

FED Invest dhe ABA Online trajnim për bletarët në Elbasan

FED Invest dhe ABA Online organizuan në Elbasan një trajnim të specializuar për bletarët me temë: “Masat parandaluese për sëmundjet në kolonitë e reja të bletëve – fokus në problemin e varroas”, të ud-

hëhequr nga eksperti i Qendra ABA, Dr. Pellumb Aleks. Aktiviteti kishte një pjesë-

mundësinë të ndanin përvojat e tyre dhe të mësonin për trajtimet sezonale të kolonive të bletëve. Fokus i veçantë iu kushtua sëmundjes së varroas, e njohur si një nga sfidat kryesore që ndikon në shëndetin dhe produktivitetin e bletëve në nivel global.

Gjatë trajnit, pjesëmarrësit morën njohuri të detajuara mbi masat parandaluese, menaxhimin e kolonive të reja dhe praktikën më efektive për trajtimin e varroas, duke i mundësuar atyre të përmirësojnë prodhimin dhe të ruajnë shëndetin e kolonive.

Ky aktivitet theksoi rëndësinë e edukimit të vazhdueshëm dhe bashkëpunimit ndërmjet profesionistëve të bletarisë, duke promovuar zhvillimin e një sektori më të qëndrueshëm dhe më produktiv. Organizatorët nënvizuan se informimi dhe shkëmbimi i përvojave janë elementë kyç për përballimin e sfidave të sektorit dhe për rritjen e konkurrueshmërisë së prodhimit të mjaltit në Shqipëri.

Trajnimi i Elbasanit shërben gjithashtu si model për aktivitete të ngjashme që do të zhvillohen në të ardhmen, duke synuar fuqizimin e rolit të grave në bletari dhe avancimin e njohurive teknike të të gjithë bletarëve në vend.



tarët me temë: “Masat parandaluese për sëmundjet në kolonitë e reja të bletëve – fokus në problemin e varroas”, të ud-

marrje të gjerë, sidomos nga gratë bletare, dhe u zhvillua në një atmosferë diskutimi të hapur, ku pjesëmarrësit patën

FSHZH anulon tenderin 4.5 mln euro të Fermës së dijes në Divjakë, operatorët ankohen në KPP

Një procedurë prokurimi që kishte në objekt ndërtimin e një ferme agroturistike dhe ullishteje si një model zhvillimi në Divjakë është anuluar nga Fondi Shqiptar i Zhvillimit.

Kontrata “Ndërtimi i infrastrukturës së modeleve të integruara në zona me potencial zhvillimi, Divjakë: “Ferma e dijes dhe agroturizmit të ullishteve, Divjakë” me një fond limit 458 milionë lekë apo rreth 4.5 milionë euro nuk arriti të finalizohet.

Në sistemin e prokurimeve FSHZH ka argumentuar se kjo procedurë do të anulohet “për shkak të rrethanave të paparshtueshme dhe objektivitetit ose entit kontraktor kanë ndryshuar”.

Por duket se një hap i tillë nuk është mirëpritur nga operatorët ekonomikë të cilët e kanë ankimuar procedurën pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Lidhur me arsyen e ankimit kjo është kategorizuar si “tjetër”. Tenderi në fjalë u hap në 9 tetor dhe u mbyll në 27 tetor 2025.

Referuar raportit teknik projekti synonte krijimin e një poli të ri zhvillimi tematik, në formën e një qendre dije dhe

një qendre rekreacioni në të cilën do të përfshihen funksione shoqërore mikse shërbimi, sporti, çlodhje dhe mjedisë për edukimin e trajnimin e brezit të ri. Zona ndodhet në lindje të qytetit të Divjakës, Bashkia Divjake. Ajo ka shtrirje lineare me drejtim Veri-Jug.



Sipërfaqja është tokë bujqësore e mbjelle me pemëtari Ullinj.

Zona e Zhvillimit me sipërfaqe prej 40 Ha, ishte projektuar për të shërbyer si një qendër multifunktionale në shërbim të dijes, rekreacionit, agrotur-

izmit dhe prodhimit e shitjes së produkteve lokale për fëmijët, të rinjtë, turistet, banoret e bizneset lokale dhe për kërkuesit e studentët e degëve bujqësore duke ofruar një gamë të gjerë të shërbimeve dhe aktiviteteve.

Në projekt parashikohen disa zona ku e para dhe e dyta

si qendër kërkimi dhe laborator shartimi, zona 3-4 fermë ullishte bio dhe hapësirë e dedikuar për kafshët, zona Hapësirë Mikpritëse (Glamping dhe Agroturizëm).

“Monitor”

Mjekësia Veterinare Shqiptare



gjithmonë me mall, respekt dhe mirënjohje.

Profesor Kristaqi lindi më 1 Gusht 1948 në Lunxheri të Gjirokastrës. Me mbarimin e shkollës së mesme në qytetin e Gjirokastrës, ai ndoqi studimet e larta për Mjekësi Veterinare në Institutin e Lartë Bujqësor.

Pas përfundimit të studimeve në vitin 1973, punoi si veterinar dhe me pas si përgjegjës i shërbimit veterinar në Tepele-në. Në vitin 1979 emërohet kërkues në Departamentin e Virologjisë në Institutin e Studimeve Veterinare në Tiranë, Institut që me vone e drejtoi, në vitet 1997 deri 2002.

Me mall dhe respekt përkujtojmë Profesor Kristaq Bërxfholi në 2 vjetorin e ndarjes së tij nga jeta.

Sot ndalemi me përlulesi për të nderuar figurën e një pedagogu të përgatitur, një drejtuesi të zotë dhe një prej virologëve më të shquar në Shqipëri. Profesor Kristaqi la gjurmë të pashlyeshme në formimin profesional të brezave të tërë studentësh, duke ndërtuar jo vetëm dije, por edhe karakter, përkushtim dhe dashuri për mjekësinë veterinarë.

Ai nuk do t'u mungojë vetëm familjarëve dhe vajzave të tij, por gjithë familjes së madhe veterinarë shqiptare dhe më gjerë. Trashëgimia e tij akademike dhe njerëzore do të jetojë në çdo student që ai frymëzoi dhe në çdo profesionist që ai udhëhoqi.

Profesor, na mungoni dhe do t'ju kujtojmë

Që nga viti 2002, ai ka dhënë një kontribut të palëkundur në Fakultetin e Mjekësisë Veterinare, duke u shquar si pedagog dhe më pas si drejtues i Departamentit të Lëndëve Paraklinike. Me një pasion të pakufizuar për shkencën dhe arsimin, Prof. Bërxfholi ka lënë gjurmë të pashlyeshme në fushën e virologjisë, imunologjisë dhe zoonozave, duke u pajisur me tituj dhe grada shkencore të larta si “Doktor Shkencash” dhe “Profesor”.

Autor i shumë publikimeve shkencore, ai ka qenë gjithashtu një zë i rëndësishëm për çështjet që prekin sigurinë ushqimore dhe shëndetin publik.

I paharruar kujtimi i profesor Kristaqit!

Falen kamatëvonesat për kontributet e prapambetura - Lehtësimi për fermerët debitorë, nëse kontributet paguhen brenda këtij viti

Të gjithë fermerët që kanë vite të prapambetura në pagesën e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore përfitojnë një lehtësim të ri ligjor.

përfitimin e pensionit.

“Çdo fermer i cili plotëson kushtet ligjore për tu vetëpunësuar në bujqësi ka të drejtën për të mbuluar periudha të

vazhdim. Ndërsa duke filluar nga 1 janar i 2026 me ligjet e fundit, fermerët nuk do të paguajnë më kamatëvonesë por do të mbulojnë masën kontributeve”, u shpreh Riza Ashimi, Specialist i përfitimeve pranë DRSSH Korçë.

Ligji i sigurimeve parashikon gjithashtu ndryshime mes fermerëve të zonave fushore dhe atyre të zonave malore, në masën e kontributeve.

“Në rastin e rretheve Korçë, Pogradec dhe Devoll do të paguhet 38 mijë e 400lek në vit ndërsa për zonat malore që futet vetëm rrethi i Kolonjës do të paguhet 29 mijë e 400 lek në vit që nga periudha e vitit 1993”, tha ai.

Falja e kamatëvonesave konsiderohet një mundësi për shumë fermerë që të rregullojnë detyrimet dhe të sigurojnë vitet e nevojshme për një pension të plotë.



Nëse ata zgjedhin t'i derdhin kontributet brenda këtij viti kalendarik, nuk do të penalizohen me kamatëvonesë apo gjoba, duke u dhënë mundësinë të plotësojnë vitet e punës për

vjetërsisë në punë nga 1 tetori i vitit 1993 dhe deri në vazhdim. Në vitin 2025 përveç detyrimit duhet të paguajnë edhe një kamatëvonesë për çdo ditë vonesë nga janari i vitit 2015 dhe në

Shkelje e kushteve higjieno-sanitare, AKU bllokoi djathë dhe produkte pule në dy subjekte

Autoriteti Kombëtar i Ushqimit (AKU) zhvilloi kontrolle në dy subjekte që ushtrojnë aktivitet në fushën e përpunimit të qumështit dhe mishit, në kuadër të planit mujor të inspektimeve me bazë rrisht për stabilizime me rrezikshmëri të lartë.

Sipas AKU-së, trupat inspektuese të Drejtorisë rajonale Tiranë konstatuan shkelje të kushteve higjieno-sanitare gjatë kontrollit në baxhon “Bonum”, ku në ambientet e përpunimit u evidentua prani myku, ndryshku dhe lagështie.

AKU bllokoi aktivitetin e baxhos, si dhe u bllokua një sasi prej 328.7 kilogramësh djathë i bardhë dhe, i konsideruar produkt i pasigurt për konsum.

Ndaj subjektit u vendos gjithashtu gjobë në vlerën 300 mijë lekë për ushtrim të aktivitetit në kundërshtim me kërkesat ligjore për higjienën e ushqimeve.

Inspektorët kryen kontrolle edhe në subjektin “KMY”, që ushtron aktivitet në përpunimin e mishit.

Në këtë rast u konstatua një

ambient ndihmës me kushte higjieno-sanitare të papërshtatshme, ku procesi i shkrirjes së produkteve kryhej në kundërshtim me normat teknike.

AKU bllokoi mjaltin ndihmës, si dhe 588 kilogramë fileto pule “super frango” dhe 150 kilogramë gjoks pule “pechunon”.

Nga këto produkte janë marrë mostra për analiza mikrobiologjike dhe sasia do të qëndrojë e bllokuar deri në daljen e rezultateve laboratorike. Ndaj subjektit u vendos gjithashtu gjobë në vlerën 300 mijë lekë.

Tregu i kooperativave financiare u rrit me 13% vitin e kaluar

Tregu i shoqërive të kursim-kreditit (SHKK) e mbylli vitin 2025 me rritje dyshifrore

Në tregun e mikrofinancës, FED Invest spikat për rritjen e financimeve të adresuara drejt sektorit të bujqësisë dhe sipërmarrjeve mikro. Me një shtrirje në të gjithë Shqipërinë, FED Invest mbështet me shërbime financiare ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe sektorin rural, duke kontribuar në rritjen e investimeve në biznes dhe në fuqizimin e ekonomisë lokale.

Nëpërmjet produkteve financiare të përshtatura për nevojat e fermerëve dhe sipërmarrjeve të vogla, institucioni synon të nxisë zhvillimin e qëndrueshëm ekonomik, veçanërisht në zonat rurale, duke lehtësuar aksesin në financim dhe duke mbështetur zgjerimin e aktivitetit prodhues.

Sipas të dhënave nga Banka e Shqipërisë, totali i aktiveve të tregut në fund të vitit arriti vlerën e 19.4 miliardë lekëve ose afërsisht 200 milionë eurove. Vlera e aktiveve të tregut është rritur me 13% krahasuar me një vit më parë.

Megjithatë, madhësia e këtij sektori ngelet modeste në raport me segmentet e tjera të tregut financiar dhe kryesisht me sektorin bankar.

Asetet e SHKK-ve përbëjnë afërsisht 0.85% të totalit të aktiveve të sistemit bankar në vend.

Aktiviteti ndërmjetësues i SHKK-ve mbështetet, në pjesën më të madhe, te depozitat e anëtarëve. Në fund të vitit të kaluar, depozitat përbënin afërsisht 63% të detyrimeve totale të sektorit. Në vlerë ato prekën shifrën e 12.3 miliardë lekëve, në rritje 6.8% me bazë vjetore.

Edhe në sektorin e SHKK-ve në dy vitet e fundit po vërehet një rritje e peshës së depozitave në valutë të huaj. Depozitat në valutë gjatë 2025 u rritën me 10%, pavarësisht efektit

negativ të kursit të këmbimit, duke qenë se bilanci raportohet në Lekë.


Ndërsa depozitat në monedhën vendase shënuan një rritje të ulët, me 6% krahasuar me fundin e vitit 2024. Peshat e depozitave në valutë ndaj totalit ka arritur në 23.1%, nga 22.5% që kishte qenë një vit më parë.

Në përgjithësi, SHKK-të ofrojnë norma interesi për depozitat më të larta se bankat tregtare, ndërsa paralelisht edhe kreditë në përgjithësi kanë norma më të larta interesi.

Rritja e depozitave të SHKK-ve vitet e fundit është mbështetur shumë edhe nga përfshirja e tyre në skemën e sigurimit të depozitave. Që prej vitit 2017, depozitat pranë SHKK-ve janë të siguruar deri në vlerën e dy milionë lekëve.

Por, sigurimi bëhet efektiv vetëm në momentin kur SHKK-ja përkatëse anëtarësohet në skemën e sigurimit të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave. Për këtë qëllim, SHKK-të duhet të certifikohen dhe të marrin një vërtetim të përbushjes së kriterëve nga Këshilli Drejtues i ASD-së. Aktualisht, ASD raporton nëntë subjekte të anëtarësuara në skemën e sigurimit të depozitave.

“Monitor”



Programi i BSH për SME-të, në 2025-n u shfrytëzua më pak se 7% e shumës në dispozicion

Programi i Bankës së Shqipërisë për mbështetjen me kredi të biznesit mikro, të vogël dhe të mesëm pati një ecuri modeste në vitin e parë të aplikimit.

Sipas informacionit të Bankës së Shqipërisë, shumat totale e financimeve, në kuadrin e këtij programi deri në fund të vitit 2025 ishte vetëm 1.7 miliardë lekë. Kjo shumë përbën më pak se 7% të shumës totale prej 25 miliardë lekësh, të vendosur në dispozicion nga Banka e Shqipërisë për këtë qëllim.

Banka e Shqipërisë bën të ditur se në total gjatë vitit u akorduan 131 kredi në kuadrin e këtij programi.

Banka e Shqipërisë nënvizon se rreth 98% e këtyre kredive janë financime të reja, çka konfirmon se programi ka shërbyer si instrument për nxitjen e investimeve shtesë.

Struktura e kreditimit tregon një përqendrim kryesisht tek bizneset e vogla dhe të mesme, të cilat kanë përfutur rreth 85% të fondeve. Nga pikëpamja sektoriale, fondet janë orientuar drejt industrisë (33.7%), tregtisë (30.5%) dhe bujqësisë (22.9%), duke reflektuar, sipas Bankës së Shqipërisë, potencialin e tyre për rritje produktiviteti.

Rreth gjysma e financimeve është përdorur për blerje pajisjesh dhe makinerish, duke treguar fokus në zgjerimin e kapaciteteve prodhuese dhe modernizimin e aktivitetit. Shpërndarja gjeografike paraqitet relativisht e balancuar, me përqendrim në qendrat kryesore ekonomike të vendit, ndërsa rreth 83% e portofolit ka maturitet 5-vjeçar, duke dëshmuar orientim afatgjatë të investimeve. Deri tani, të gjitha bankat e sistemit kanë marrë pjesë aktive në program.

Shfrytëzimin më të lartë të programit e ka arritur Raiffeisen Bank, me 32% të vlerës së disbursuar, e ndjekur nga Baka Kombëtare Tregtare, me 15%, Banka e Parë e Investimeve

(Fibank), me 13% dhe Credins Bank, me 12%.

Nëpërmjet këtij programi, Banka e Shqipërisë u angazhuar t'u ofrojë bankave tregtare likuiditet me një normë vjetore interesi prej 0.5%. Me këto fonde, sektori bankar duhet të japë kredi për SME-të me një normë interesi vjetore jo më të madhe se 3.5% në vit. Megjithatë, norma e interesit duhet të jetë më e ulët, nëse programi kombinohet me skemën e garancisë sovraane të ofruar nga qeveria shqiptare, deri në 2%, në rast se garancia sovraane mbulon 55% – 75% të rrezikut të kreditit. Programi u shty edhe për vitin 2026, me një vendim të marrë në janar të këtij viti.

Ndërkohë, të dhënat e Ministrisë së Financave, të publikuara gjatë muajit shkurt, treguan se edhe shfrytëzimi i skemës paralele të garancisë sovraane për fermerët ishte gjithashtu në nivele të dobëta. Në fund të vitit 2025, shumat e shfrytëzuara nga skema në fjalë e garancisë sovraane ishte vetëm 366 milionë lekë. Kjo shumë përbën vetëm 12% të vlerës totale të vendosur në dispozicion për këtë qëllim.

Sipas kushteve të vendimit të Këshillit të Ministrave, Ministria e Financave merrte përsipër të garantonte 70% të vlerës së huave të fermerëve, për një shumë maksimale kredie prej 25 milionë lekësh. Marrëveshja parashikonte që huadhënësit të jepnin hua të garantuar subjekteve mikro, të vogla dhe të mesme, si dhe fermerëve të cilët janë të regjistruar dhe të pajisur me certifikatën e NIPT-it të fermerit, sipas tipit të investimit në përpunje me prioritetet e sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural.

Norma e interesit të kredive të kontraktuara dhe disbursuara duhet të ishte jo më e lartë se 2%, ndërsa tarifat e aplikueshme kundrejt huamarrësve për dhënie e kredisë nuk duhet të ishin në total më të larta se niveli maksimal prej 0.5%. Huadhënësit duhet ta

ofronin kredinë me një periudhë pa pagesë principali (grace) prej jo më pak se 12 muaj. Afati maksimal i huave të garantuara nuk mund të ishte më i gjatë se pesë vjet.

Shkalla e ulët e shfrytëzimit të programeve të mbështetjes së SME-ve dhe fermerëve duket se konfirmojnë rezervat e bankave, se këto skema nuk ishin ndërtuar në mënyrë shumë funksionale.

Drejtimesit e bankave shprehën rezerva të shumta rreth këtyre instrumenteve, duke filluar sidomos nga kufizimet e vendosura mbi normën e interesit. Ata argumentuan se huadhënia me norma kaq të ulëta interesi për fermerët dhe bizneset e vogla dhe mikro është shumë e vështirë, për shkak të kostove dhe rreziqeve të larta.

Në takimin e muajit shkurt me qeverinë dhe Bankën e Shqipërisë, bankierët shtruan edhe disa propozime të tjera, si zgjatjen e afatit maksimal të kreditit, bërjen opsionale të periudhës favorizuese (grace period), sqarimin e statusit tregtar të fermerit me atë fiskal, marketing më të koordinuar dhe më intensiv që të njihet gjerësisht produkti, si dhe një përcaktim më i mirë i investimeve të lejuara në kuadrin e këtyre skemave.

Lidhur me vërejtjet e shprehura nga sektori bankar, Banka e Shqipërisë shprehet për “Monitor” se është në monitorim të vazhdueshëm të ecurisë së programit, si dhe në dialog me partnerët tanë, duke u përpjekur, brenda piketave kryesore të programit, të maksimizojë ndikimin e tij në ekonomi.

Sipas Bankës së Shqipërisë, në vijim të dialogut me Shoqatën Shqiptare të Bankave dhe kërkesës së tyre, në fillim të vitit 2026 u zgjatën afatet e shqyrtimit të kërkesave, miratimit dhe disbursimit të kredive prej bankave tregtare, deri në fund të këtij viti.

“Monitor”

Ibrahimaj: Financim deri në 9 milionë lekë për startup-et, në 2026-ën

Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, Delina Ibrahimaj, dha detaje të skemës së financimit për startup-et në kuadër

jektëve, në varësi të fazës së zhvillimit të startup-it, duke filluar nga faza fillestare deri te shkallëzimi i biznesit.

barrën e kostove fillestare.

Për startup-et në fazën e validimit (F2), mbulimi arrin 85% të kostove të buxhetit të miratuar, deri në 4,500,000 lekë, duke ndihmuar testimin

dhe përsosjen e produkteve në treg.

Ndërsa për ato në fazën e rritjes (F3), programi ofron mbulim prej 75% të kostove të buxhetit, deri në 9,000,000

lekë, duke lehtësuar shkallëzimin dhe zgjerimin e bizneseve me potencial të lartë.

Ministria Ibrahimaj theksoi se kjo strukturë financimi synon të krijojë një

ekosistem të qëndrueshëm për startup-et, duke inkurajuar inovacionin, testimin e produkteve dhe rritjen e qëndrueshme të sipërmarrjeve shqiptare.



të Grant 2026, një iniciativë që synon të mbështesë zhvillimin e ideve të reja dhe rritjen e bizneseve inovative në vend.

Sipas ministres, programi ofron një mbulim të pjesës më të madhe të kostove të pro-

Në fazën fillestare (F1), skema garanton mbulim 100% të kostove të projektit, me një maksimum prej 1,500,000 lekë, duke mundësuar që sipërmarrësit të fokusohen te zhvillimi i idesë pa pasur

STARTUP ALBANIA

Fazat e startupeve në GRANT 2026

FAZA E VALIDIMIT 4.5 milionë lekë

- Produkt ose shërbim i testuar
- Klientë të parë / pilotime
- Model biznesi në validim

Startup i regjistruar ligjërisht

STARTUP ALBANIA

Fazat e startupeve në GRANT 2026

FAZA E RITJES 9 milionë lekë

- Produkt në treg
- Të ardhura ose rritje e qartë
- Fokus në shkallëzim (scale-up)

STARTUP ALBANIA

Fazat e startupeve në GRANT 2026

FAZA FILLESTARE 1.5 milionë lekë

- Ide ose koncept biznesi
- Produkt/servis ende në zhvillim
- Startup në hapat e parë

E përshtatshme për individë ose epike në fillim

POLITIKA FISKALE

Fasonët kërkojnë lehtësira fiskale: Zero taksë për lëndët e para, të rritet pragu i tatueshëm mbi të ardhurat

Sektori i manufakturës ka propozuar një paket lehtësira ash në komisionin e Ekonomisë dhe Financave për të dal nga gjendja e vështirë ku ndodhet. Disa nga kërkesat kryesore ishin rritja e koeficientit të amortizimit për makinerit, zerimi i taksave për lëndën e parë si dhe mekanizma kompensues për kursin e këmbimit.

Gjithashtu shoqata kërkon që garancia shtetërore të jetë permanente, me normë interesi 2.5% dhe me mbulim kolateral deri në 70%.

“Sa i takon rritjes së koeficientit të amortizimit, nga 20% që është aktualisht, të rritet në 40%, sa i takon pajisjeve makineri për prodhimin, pra investimet dhe inovacionin”, tha Edvin Prençe kryetar i ProEksport Albania

“Taksat duhet të hiqen, duhet të zerohen”, u shpreh Florian Zekia, anëtar i ProEksport Albania.

Rishikimi i Tatimit mbi të Ardhurat Personale dhe rimbursimi pas rritjes së pagës minimale të zbatohet për të gjitha nivelet e pagave ishin disa propozim e tjera.

“Ajo që kërkojmë ne është që të mos kufizohemi me një numër të caktuar punonjësish të përzgjedhur. Ky suport të

bëhet me një kompensim fiks për 9 muaj siç e ka menduar qeveria, por të bëhet për të gjithë numrin e punonjësve

anëtar i ProEksport Albania.

Gjatë vitit të fundit, rënia e eksporteve u shoqërua edhe me shkurtime të vendeve të



për këtë diferencën 16.7% e 10 mijë lekshit që është shtesa e pagës”, deklaroi Saimir Bidaj,

punës shifër e cila arriti në rreth 12 mijë në sektorin e fasonerisë.

Mbrojtja e natyrës, prioritet për Shqipërinë dhe BE, Gonzato: Veprime konkrete përtej përafrimit të politikave

Bashkimi Europian rikonfirmon mbështetjen për Shqipërinë në mbrojtje të pasurive natyrore, përmes

ruajtjen e bregdetit, lumenjve, pyjeve, lagunave dhe maleve të Shqipërisë.

Ambasadori i BE-së në

përballuar presionin në rritje mbi zonat e mbrojtura. Për më tepër, projekti po e ndihmon vendin të ecë përpara drejt standardeve mjedisore të BE-së. Por mbrojtja e natyrës shkon përtej përafrimit të politikave; kërkon veprime konkrete në terren”, u shpreh ai.

Projekti EU4Nature synon të forcojë kapacitetet institucionale për administrimin e zonave të mbrojtura, të përmirësojë planifikimin territorial dhe të nxisë praktika që garantojnë zhvillim të qëndrueshëm, në përputhje me standardet mjedisore të Bashkimit Europian.

Mbështetja realizohet në bashkëpunim me institucionet shqiptare dhe strukturat përkatëse të BE-së si dhe në koordinim me Ministrinë e Mjedisit.

BE thekson se mbrojtja e natyrës është një element kyç i procesit të integritimit europian dhe kërkon angazhim të vazhdueshëm institucional dhe zbatim efektiv në terren.

Tiranë, Silvio Gonzato, theksoi se projekti EU4Nature mund të luajë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e biodiversitetit të vendit.

“Projekti EU4Nature mund të luajë një rol të rëndësishëm në ruajtjen e biodiversitetit të Shqipërisë. Megjithatë, edhe autoritetet shqiptare duhet të bëjnë pjesën e tyre për të



projektit EU4Nature, që synon menaxhim më të mirë të zonave të mbrojtura, planifikim më të zgjuar dhe zbatimin e zgjidhjeve të bazuara në natyrë.

Në një kohë kur turizmi po zgjerohet dhe presioni mbi mjedisin e biodiversitetin po rritet, mbështetja e BE-së konsiderohet vendimtare për

Avancimi i investimeve amerikane, Bordi i AmCham takim me VanHorn

Bordi i Drejtorëve i Dhomës Amerikane të Tregtisë në Shqipëri zhvilloi një drekë pune me të Ngarkuarën me Punë të SHBA-së, Nancy VanHorn, në

tivi, Bordi i AmCham vendos theks të veçantë në prioritetet e tij kryesore të advokimit, të përqendruara në përmirësimin e klimës së biznesit dhe

ruar dhe funksional që siguron dialog kuptimplotë, transparencë dhe reagim institucional të argumentuar. Forcimi i përfshirjes së palëve të interesuara është thelbësor për ndërtimin e besimit dhe për të siguruar që reformat ligjore dhe rregullatore të jenë të balancuara, të parashikueshme dhe të zbatohen në mënyrë efektive.

Në kuadrin më të gjerë të diskutimeve mbi klimën e investimeve, u theksua rëndësia e krijimit të një mjedisi biznesi gjithnjë e më tërheqës dhe konkurrues për kompanitë e mëdha ndërkombëtare, përfshirë investitorët amerikanë. Diskutimi trajtoi gjithashtu mekanizmin e shqyrtimit të investimeve si një instrument të rëndësishëm në kontekstin e sigurisë kombëtare dhe investimeve strategjike.

AmCham rikonfirmoi qëndrimin e saj se forcimi i kuadrin të investimeve në Shqipëri duhet të përqendrohet në ndërtimin dhe promovimin e procedurave transparente, efikase dhe të parashikueshme për investitorët e huaj. Garantimi i sigurisë ligjore dhe qartësisë rregullatore mbetet thelbësor për rritjen e besimit të investitorëve dhe për pozicionimin e Shqipërisë si një destinacion i besueshëm për investime ndërkombëtare cilësore.

Dreka e punës rikonfirmoi partneritetin strategjik afatgjatë midis AmCham dhe Ambasadës së SHBA-së. Mesazhi i përbashkët ishte i qartë: avancimi i sigurisë ligjore, forcimi i dialogut institucional dhe promovimi i procedurave transparente dhe të parashikueshme janë thelbësore për tërheqjen e investimeve ndërkombëtare cilësore, nxitjen e inovacionit dhe mbështetjen e zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik të Shqipërisë.



një diskutim të hapur dhe konstruktiv mbi prioritetet kryesore që ndikojnë në mjedisin e biznesit në Shqipëri.

Takimi u zhvillua në vijim të angazhimeve që synojnë forcimin e mëtejshëm të partneritetit mes AmCham dhe Ambasadës së SHBA-së, si dhe përforcimin e objektivit të përbashkët për avancimin e marrëdhënieve ekonomike midis Shqipërisë dhe Shteteve të Bashkuara.

Në mbështetje të këtij objek-

forcimin e kuadrin rregullator. Përmes komiteeve të tij sektoriale aktive, AmCham promovon reforma që lidhen me parashikueshmërinë rregullatore dhe fiskale, inovacionin, sigurinë, qëndrueshmërinë dhe sfidat specifike sektoriale, si në sektorët digjital, të shëndetësisë dhe turizmit.

Theks i veçantë iu kushtua efektivitetit të procesit të konsultimit publik. Bordi nënvizoi nevojën për krijimin e një mekanizmi konsultimi të strukturo-

Procesi i rivlerësimit të pasurive, Malaj: Jashtë Tiranës vetëm me vlerësues privat

Ministri i Financave, Petrit Malaj, deklaroi se procesi i rivlerësimit të pasurive të paluajtshme ka nisur në të gjithë vendin.

Gjatë mbledhjes së grupit parlamentar të PS-së, Malaj bëri të ditur se për pasuritë jashtë Tiranës rivlerësimi nuk mund të kryhet me çmime reference, por vetëm përmes një vlerësuesi privat.

Sipas tij, kjo vjen pas kontrolleve të ushtruara nga Administrata Tatimore në agjencitë imobiliare, ku është konstatuar se çmimet e pasurive të paluajtshme të regjistruara në sistemet e tyre rezultojnë dukshëm më të larta se çmimet e referencës.

Ndërkohë, qytetarët e Tiranës do të kenë mundësi ta kryejnë rivlerësimin e pasurive të tyre ose mbi bazën e çmimeve të referencës të regjistruara pranë Agjencisë Shtetërore të Kadastrës (ASHK), ose përmes një vlerësuesi privat.

“Procesi i rivlerësimit tashmë

është i hapur. Udhëzimi ka dalë dhe është publikuar të hënën në Fletoren Zyrtare. Është një proces që mund të vijojë normalisht



si në Tiranë ashtu edhe në pjesën tjetër të vendit. Jemi në diskutim sa i përket çmimeve të reja të referencës për zonat jashtë Tiranës, pasi nga kontrollet e fundit të autoriteteve tatimore në zyrat imobiliare në Tiranë dhe më gjerë

janë evidentuar diferenca mes çmimeve të regjistruara pranë ASHK-së dhe atyre që rezultojnë në sistemet e këtyre zyrave”, u

shpreh Malaj. Ai theksoi se qytetarët që dëshirojnë të bëjnë rivlerësimin e pronave jashtë territorit të Tiranës, për momentin duhet ta kryejnë këtë proces përmes një vlerësuesi privat.



SHOQATAT ANËTARE

AVALB FEDINVEST BKFSH EKR IBMA HABA AOA UPM LEAA ADAMA ABA SHGF ALBAFLOR

SHKPVF RKUK SVP MSHKM BIOADRIA PPAM SHT UOTSH KEA BIOPANT ADAD PSN

KËSHILLAT RAJONALE

TIRANA DURRESI FIERI ELBASANI SHKODRA DIBRA

LEZHA GJIROKASTRA KORÇA BERATI VLORA KUKESI



Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar

www.kashalbania.org

Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar



KREDI E SHPEJTË MIKRO PËR ÇDO QËLLIM BIZNES APO INDIVID

KREDI MIKRO

deri në **2,500,000** LEKË



Ndotja mikrobiologjike e ujërave bregdetare në zonat urbane mesdhetare: Evidencë shkencore, shkaqe sistemike dhe analizë e integruar e rastit të bregdetit të jugut (Shqipëri)

Nga Aulona Veizi, Dr. e Shkencave

Abstrakt

Ndotja mikrobiologjike e ujërave bregdetare përbën një nga sfidat më serioze mjedisore dhe të shëndetit publik në zonat urbane mesdhetare. Ky fenomen intensifikohet nga urbanizimi i shpejtë bregdetar, presioni sezonal turistik, infrastruktura e paplotë e kanalizimeve dhe mungesa e koordinimit institucional. Literatura shkencore ndërkombëtare identifikon në mënyrë të qëndrueshme shkarkimet e ujërave urbane të patrajuara ose pjesërisht të trajtuara, lidhjet e paligjshme midis rrjeteve, keqmenaxhimit e ujërave të shiut dhe aktivitetet detare si burime kryesore të ndotjes mikrobiale. Ky artikull integron evidencën shkencore ndërkombëtare me një analizë teknike të thelluar të rastit të Bregdetit të Jugut në Shqipëri, bazuar në të dhënat zyrtare të monitorimit (2020–2025), verifikime në terren dhe dokumentacion teknik-institucional. Rezultatet tregojnë një përputhje të fortë midis modeleve globale të ndotjes bregdetare dhe dinamikave lokale, duke konfirmuar se ndotja mikrobiale është një problem sistematik që kërkon menaxhim të integruar, investime infrastrukturore dhe qeverisje ndërinstitucionale të qëndrueshme.

Fjalë kyçe: ndotje bregdetare, ndotje mikrobiologjike, ujëra të ndotura urbane, Mesdheu, menaxhim i integruar i ujërave

1. Hyrje

Zonat bregdetare përqendrojnë një pjesë disproporcionale të popullsisë, aktivitetit ekonomik dhe turizmit, duke u bërë veçanërisht të ndjeshme ndaj degradimit mjedisor (UNEP, 2021). Në pellgun e Mesdheut, karakteristikat hidrodinamike të detit, së bashku me presionin antropogjen dhe zhvillimin urban intensiv, kufizojnë aftësinë natyrore të vetëpastrimit të ujërave bregdetare (EEA, 2020).

Ndotja mikrobiologjike e ujërave larëse përbën një rrezik të drejtpërdrejtë për shëndetin publik, biodiversitetin detar dhe qëndrueshmërinë e ekonomisë turistike (WHO, 2021). Studimet ndërkombëtare theksojnë se ndotja bregdetare nuk është një problem i izoluar lokal, por pasojë e dështimeve strukturore në menaxhimin e ujërave të ndotura, planifikimin urban dhe koordinimin institucional (Islam & Tanaka, 2004; Viaroli et al., 2015).

2. Metodologjia

Studimi bazohet në një qasje të integruar që përfshin: Rishikim sistematik të literaturës shkencore mbi ndotjen bregdetare dhe mikrobiologjike;

Analizë të të dhënave zyrtare të monitorimit të cilësisë së ujërave bregdetare për periudhën 2020–2025;

Verifikime teknike në terren mbi infrastrukturën e kanalizimeve dhe drenazhimit;

Analizë të dokumentacionit teknik dhe konsultime institucionale me strukturat përgjegjëse.

Kjo metodologji lejon krahasimin e drejtpërdrejtë midis evidencës shkencore globale dhe realitetit lokal të Bregdetit të Jugut

3. Evidenca shkencore mbi ndotjen bregdetare

Literatura shkencore identifikon disa burime të përsëritura të ndotjes mikrobiale në zonat bregdetare:

Trajtimi jo i plotë i ujërave të ndotura urbane, veçanërisht kur aplikohet vetëm trajtim parësor;

Lidhjet e paligjshme midis rrjeteve të ujërave të zeza dhe ujërave të shiut;

Keqmenaxhimi i drenazhimit urban në projekte bregdetare; Shkarkimet nga aktivitetet portuale dhe mjetet lundruese;

Zhvillimi urban dhe turistik pa përmirësim paralel të infrastrukturës.

Në Mesdhe, këta faktorë prodhojnë ndotje persistente për shkak të kapacitetit të kufizuar të shpërndarjes dhe vetëpastrimit të ndotësve (Viaroli et al., 2015).

4. Studimi i rastit: Bregdeti i Jugut (Shqipëri)

4.1 Zonat kritike të ndotjes

Analiza e të dhënave të monitorimit evidenton segmente kronikisht problematike të dhena nga Raporti i Agjensise Kombetare të Mjedisit):

Shkolla e Marinës – Plazhi i Ri;

Zvërnec (zona Kapiteni);

Orikum (Bojo-1).

Këto zona përkrijnë me terriore me presion të lartë urban dhe turistik.

4.2 Shkaqet teknike dhe institucionale të ndotjes

Analiza e detajuar identifikon ndotjen mikrobiale si rezultat të një kombinimi faktorësh:

Shkarkime të ujërave urbane të patrajuara ose pjesërisht të trajtuara, për shkak të:

Funksionimit të pjesshëm të impiantit të trajtimit (trajtim kryesisht mekanik, ~35% efikasitet);

Mungesës së trajtimit paraprak të ujërave teknologjike nga aktivitetet industriale ushqimore;

Mungesës së njësive për kapjen e yndyrnave në restorante, duke dëmtuar kapacitetin hidraulik të rrjetit.

Lidhje të paligjshme midis ujërave të zeza dhe ujërave të shiut, të cilat i kthejnë kolektorët e drenazhimit në burime direkte ndotjeje. Ndërhijet e realizuara në kuadër të projektit Lungomare 2 kanë treguar se ndërprerja e këtyre daljeve sjell përmirësim të menjëhershëm të cilësisë së ujit.

Mungesë rrjeti kanalizimesh në zona si Zvërneci, ku përdorimi i gropave septike në kushte hidrogjeologjike të pafavorshme çon në infiltrime direkte drejt detit.

Problematika hidraulike të projekteve urbane, ku mungesa e integritit të plotë të sistemit të drenazhimit ka krijuar grumbullime ujërash, përmytje urbane dhe shkarkime të pakontrolluara gjatë reshjeve intensive.

Shkarkime nga mjetet lundruese, të kombinuara me kontroll institucional të pamjaftueshëm, të cilat shpërndahen nga rrymat detare përgjatë vijës bregdetare.

5. Kuadri i masave dhe qasja e integruar

Plani i Masave i propozuar për Bregdetin e Jugut është në përputhje me politikat mjedisore të BE-së dhe përfshin:

Masa afatshkurtra për mbrojtjen e shëndetit publik;

Masa afatmesme për rehabilitimin dhe zgjerimin e infrastrukturës;

Masa strukturore për menaxhim të integruar të ujërave.

Një element inovativ është aplikimi i ekonomisë qarkuluese, përmes grumbullimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura nga anijet për prodhim energjie në bujqësi, model i testuar me sukses në zona të tjera bregdetare.

6. Diskutim

Rasti i Bregdetit të Jugut konfirmon se ndotja mikrobiale është kryesisht rezultat i dështimeve infrastrukturore dhe institucionale. Përmirësimet e vëzhguara në zonat me trajtim të plotë (p.sh. Oriku) demonstrojnë lidhjen e drejtpërdrejtë midis efikasitetit të trajtimit dhe cilësisë së ujit.

7. Përfundime

Ndotja mikrobiologjike e ujërave bregdetare në Bregdetin e Jugut pasqyron tendencat e dokumentuara për qytetet mesdhetare. Zgjidhja kërkon ndërprerje të burimeve të ndotjes, investime infrastrukturore, forcim të kontrollit institucional dhe koordinim ndërinstitucional të qëndrueshëm. Qasja e integruar e paraqitur në këtë studim ofron një model të transferueshëm për menaxhimin e ndotjes bregdetare në kontekstin mesdhetar.

Referenca

Carpenter, S. R., Caraco, N. F., Correll, D. L., Howarth, R. W., Sharpley, A. N., & Smith, V. H. (1998). Nonpoint pollution of surface waters with phosphorus and nitrogen. *Ecological Applications*, 8(3), 559–568.

EEA. (2020). State of bathing waters in Europe. European Environment Agency.

Islam, M. S., & Tanaka, M. (2004). Impacts of pollution on coastal and marine ecosystems. *Marine Pollution Bulletin*, 48(7–8), 624–649.

Kay, D., Wyer, M. D., Crowther, J., et al. (2008). Faecal indicator organism concentrations in coastal waters. *Water Research*, 42(14), 3735–3748.

UNEP. (2021). From pollution to solution. United Nations Environment Programme.

UNEP/MAP. (2019). State of the Mediterranean marine and coastal environment. Athens.

Viaroli, P., Lasserre, P., & Campostrini, P. (2015). Coastal lagoons: ecosystem processes and modeling. Springer.

WHO. (2021). Guidelines on recreational water quality. World Health Organization.

72% e bashkive, në shtesë natyrore negative më 2024; Jugu në “Vdekje Klinike”

Shqipëria po shtegton nga tranzicioni drejt një krizë ekzistenciale demografike. Të dhënat e shtesës natyrore për vitin 2024 dëshmojnë se 44 bashki nga 61 gjithsej kishin shtesë natyrore negative sipas të dhënave të INSTAT. Rreth 72% e bashkive ishin me shtesë natyrore negative.

(-81.8) dhe Finiqi (-80.5). Këto zona po përjetojnë atë që sociologët e quajnë “implozion demografik (shkrumbim i popullsisë)”.

Për ekonominë lokale, kjo do të thotë fundi i konsumit. Bizneset e vogla, shërbimet dhe tregtia në këto zona po mbyllen pasi nuk ka më blerës. Mungesa e moshës riprodhuese tregon se këto bashki janë kthyer në azile gjigante në qiell të hapur, ku e vetmja e ardhur mbetet pensioni dhe remitancat, duke e bërë rritjen ekonomike të pamundur.

Jugu në “Vdekje Klinike”

Në krye të listës së bashkive me rënien më drastike të shtesës natyrore qëndrojnë Dropulli (-89.6%), Pusteci

Akset Turistike dhe paradoksi i shtëpive bosh

Bashkitë si Himara (-64.4%), Përmeti (-62.1) dhe Saranda (-19.5) shfaqin zhvillime shqetësuese Megjithëse turizmi po lulëzon, baza e popullsisë në këto zona po shkrifet. Ky trend paralajmëron një krizë afatgjatë për sektorin e hotelesisë.

Pa një popullsi vendase të re, këto zona do të jenë plotësisht të varura nga punëtorët e huaj (nga Azia apo Afrika), duke rritur kostot e operimit dhe duke

ndryshuar profilin e shërbimit.

“Ishujt” e mbijetesës Tirana, Kamza dhe Veriu

Në anën tjetër Kamza (119.4%) dhe Tirana (61.9%) mbeten motorët e vetëm demografikë, me shtesë natyrore pak të dukshme. Megjithatë, rritja e tyre nuk është organike, por për shkak zhvendosjes së popullsisë nga qarqet e tjera.

Teksa kostoja e jetesës në Tiranë po bëhet pengesë për lindshmërinë e mëtejshme. Zonat e veriut si Kukësi

(73.3%), Dibra (68.35) dhe Kurbini (15.75), të cilat ruajnë një shtesë pozitive.

Por edhe këtu, ekonomia nuk përfiton. Këto zona po prodhojnë burime njerëzore për eksport, ku të rinjtë që lindin aty, sapo arrijnë moshën e punës, emigrojnë drejt BE-së ose Tiranës, duke e lënë veriu me një bilanc pozitiv lindjesh por me një varfëri kronike investimesh.

Me një shtesë natyrore që në totalin kombëtar po shkon drejt zeros ose minusit, nëse heqim metropolet,

Shqipëria po humbet dividendin demografik. Me më pak lindje dhe më shumë vdekje (plakje), raporti kontribuues/përfitues do të rëndohet, duke detyruar qeverinë të rrisë taksat ose moshën e daljes në pension.

Industritë fason dhe ato përpunuese, që deri dje bazoheshin te kostoja e lirë e punës në rrethe si në Librazhd apo Krujë do të detyrohen të mbyllen ose të robotizohen me ritme të shpejta për shkak të mungesës fizike të punëtorëve.

“Monitor”

‘Nga Toka te Teknologjia: Transformimi Rural në Kinën Moderne

Nga Etleva Xhajanka

Zhvillimi rural në Kinë, i nxitur nga Plani i 15-të Pesëvjeçar, paraqet një model unik të zhvillimit të qëndrueshëm, ku transformimi ekonomik bashkëjeton me ruajtjen e ekosistemeve dhe kulturës lokale. Përmes investimeve të strukturuar në infrastrukturë, teknologji bujqësore, energji të rinovueshme dhe menaxhim të burimeve natyrore, Kina po ndërton fshatra të integruar, që kombinojnë produktivitetin ekonomik me mirëqenien sociale. Ky model nuk fokusohet thjesht tek rritja e prodhimit, por edhe tek përmirësimi i cilësisë së jetës së banorëve ruralë, përmes qasjeve inovative në arsim, shëndetësi, transport dhe mbrojtjen e mjedisit. Për më tepër, strategjia e zhvillimit rural të Kinës, promovon një bashkëpunim të ngushtë midis qeverisë, komuniteteve dhe sektorit privat, duke krijuar një ekosistem të qëndrueshëm zhvillimi, i cili mund të shërbejë si shembull për vende të tjera në transformimin e zonave rurale në motorë të rritjes ekonomike dhe social-ekologjike.

Ndërtimi rural në Kinë: Arkitektura e heshtur e modernizimit kombëtar

Në hartën e madhe të modernizimit kinez, fshati nuk është më periferia e harruar e zhvillimit, por një hapësirë strategjike ku projektohet e ardhmja. Ndërtimi rural në Kinë, i lexuar përtej shifrave dhe programeve teknike, shfaqet sot si një proces i thellë transformimi shoqëror, ekonomik dhe territorial – një arkitekturë e heshtur që mban peshën e stabilitetit kombëtar dhe ambicieve globale të vendit.

Në qendër të këtij transformimi qëndron një ide themelore: modernizimi kinez nuk mund të jetë i plotë pa modernizimin rural. Fshati nuk shihet më vetëm si burim ushqimi apo rezervuar force pune, por si një hapësirë jetese, prodhimi, kulture dhe inovacioni, e integruar në mënyrë organike me qytetin dhe ekonominë kombëtare.

Ruraliteti si çështje gjeoekonomike

Rilindja rurale në Kinë nuk është thjesht një projekt social; ajo është një strategji gjeoekonomike. Në një vend me popullsi të madhe, me presion të vazhdueshëm mbi burimet dhe me ambicie për siguri ushqimore, fshati përbën një nje kritike të sovranitetit ekonomik.

Politikat për forcimin e kapaciteteve prodhuese bujqësore, mbrojtjen e tokës dhe zhvillimin e zinxhirëve të vlerës në bujqësi janë pjesë e një arkitekture më të gjerë sigurie kombëtare. Ruajtja e “vijës së kuqe” të tokës bujqësore dhe investimi në tokë të standardeve të larta nuk janë

thjesht masa teknike, por garanci për stabilitet afatgjatë në një botë gjithnjë e më të fragmentuar dhe të pasigurt.

Kina e sheh bujqësinë jo si një sektor të prapambetur, por si një shtyllë moderne të ekonomisë kombëtare, të teknologjizuar, të gjelbër dhe të orientuar drejt cilësisë dhe markës. Në këtë kuptim, fshati bëhet laborator i një modeli të ri zhvillimi, ku prodhimi dhe ekologjia nuk janë kundërshtare, por aleate.

Nga prodhimi tradicional te bujqësia inteligjente

Një nga shtyllat kryesore të ndërtimit rural është transformimi teknologjik i bujqësisë. Investimet në farëra të avancuara, makineri bujqësore inteligjente dhe pajisje të përshtatura për terrene të vështira shënojnë kalimin nga bujqësia intensive në krah pune drejt bujqësisë së bazuar në dije dhe inovacion.

Ky tranzicion ka një domethënie të thellë gjeoekonomike: ai rrit produktivitetin pa rritur presionin mbi tokën, ul varësinë nga importet ushqimore dhe krijon një sistem prodhimi më rezistent ndaj krizave klimatike dhe tregtare.

Paralelisht, zhvillimi i një sistemi ushqimor të larmishëm – që përfshin bujqësinë, blegtorinë, peshkimin dhe ekonominë e pyjeve – synon të ndërtojë elasticitet strukturor. Fshati kinez, në këtë vizion, nuk është monokulturë, por mozaik funksionesh ekonomike që e bëjnë atë më të qëndrueshëm dhe më konkurrues.

Fshati si hapësirë jetese moderne

Ndërtimi rural nuk kufizohet

vetëm te prodhimi. Një nga dimensionet më domethënëse të këtij procesi është përmirësimi i kushteve të jetesës. Infrastruktura moderne, shërbime publike më të aksesueshme, mjedis i pastër dhe planifikim territorial i integruar janë elementë kyç për ta bërë fshatin një vend ku njerëzit jo vetëm punojnë, por edhe zgjedhin të jetojnë.

Përvoja e programeve pilot, si modeli i Zhejiang-ut, tregon se rilindja rurale kërkon qasje të diferencuar, të përshtatur me karakteristikat lokale. Nuk ka një model unik për të gjitha zonat rurale të Kinës; ka strategji fleksibël, të ndërtuara mbi identitetin, burimet dhe potencialin e secilit territor.

Në këtë kuadër, ndërtimi i “fshatit të bukur” nuk është një slogan estetik, por një projekt i plotë socio-ekonomik, ku mjedisi, kultura dhe ekonomia ndërthuren për të krijuar hapësira jetese dinjitoze dhe funksionale.

Integrimi urban-rural: fundi i një ndarjeje historike

Një nga ambiciet më të mëdha të politikave kineze është kapërcimi i ndarjes tradicionale midis qytetit dhe fshatit. Integrimi urban-rural shfaqet si një proces dy-drejtësh: qyteti sjell kapital, teknologji dhe shërbime në fshat, ndërsa fshati ofron burime, hapësirë dhe stabilitet social.

Ky integrim përforcohet nga reformat në menaxhimin e tokës, nga qarkullimi më fleksibël i faktorëve të prodhimit dhe nga politikat që inkurajojnë njerëzit të jetojnë, punojnë dhe investojnë në zonat rurale. Fshati nuk është më stacion tranziti drejt qytetit, por destinacion zhvillimi.

Në këtë kontekst, urbanizimi nuk shihet si zhvendosje

masive, por si proces i njerëzcentruar, që ruan lidhjet sociale dhe kulturore, ndërsa garanton akses të barabartë në shërbime publike.

Ekonomia rurale dhe zinxhirët e vlerës

Rilindja rurale në Kinë synon të krijojë ekonomi lokale dinamike, të bazuara në avantazhet krahasuese të çdo zone. Zhvillimi i industrive karakteristike rurale, përpunimi agro-industrial dhe integrimi i sektorëve primar, sekondar dhe terciar krijojnë zinxhirë vlerë që mbajnë më shumë të ardhura brenda komuniteteve rurale.

Ky model ul varësinë nga transfertat fiskale dhe forcon vetë-qëndrueshmërinë ekonomike të fshatit. Në të njëjtën kohë, ai e lidh zhvillimin rural me tregjet kombëtare dhe ndërkombëtare, duke e bërë fshatin pjesë aktive të ekonomisë globale.

Lufta kundër varfërisë si proces i vazhdueshëm

Edhe pse Kina ka arritur rezultate historike në uljen e varfërisë, ndërtimi rural e sheh këtë arritje jo si fund, por si fillim të një faze të re. Parandalimi i rikthimit në varfëri dhe mbështetja e zonave ende të brishta janë pjesë e një mekanizmi afatgjatë sigurie sociale.

Kjo qasje reflekton një filozofi zhvillimi që kombinon rritjen ekonomike me drejtësinë sociale. Fshati, në këtë vizion, nuk lihet pas nga modernizimi, por mbrohet dhe fuqizohet për të qenë pjesë e tij.

Ndërtimi rural si projekt civilizues

Në thelb, ndërtimi rural në

Kinë është më shumë se një program zhvillimi: është një projekt civilizues. Ai synon të krijojë një shoqëri ku zhvillimi ekonomik, harmonisë sociale dhe mbrojtja e mjedisit ecin së bashku.

Duke investuar në fshat, Kina po investon në stabilitetin e saj të brendshëm dhe në peshën e saj gjeoekonomike globale. Në një botë të përballur me pasiguri ushqimore, kriza klimatike dhe polarizim social, modeli kinez i ndërtimit rural ofron një qasje alternative: zhvillim i balancuar, i planifikuar dhe i orientuar drejt së ardhmes.

Në këtë kuptim, në filozofinë e qeverisë së Republikës Popullore të Kinës, për zhvillimin rural, fshati nuk është thjesht rrënjja e së kaluarës, por themeli mbi të cilin ngrihet modernizimi i së nesërme.

Nga Fshati Global te Partneriteti Strategjik: Boshti Kinë-Europë-Shqipëri në Zhvillimin Rural

Përtej dimensionit të brendshëm, transformimi rural në Republika Popullore të Kinës krijon hapësira reflektimi dhe bashkëpunimi edhe në nivel ndërkombëtar, duke shndërruar fshatin në një platformë strategjike bashkëpunimi, Kinë-Europë-Shqipëri në Zhvillimin Rural, ku fshati shfaqet si urë lidhëse për praktikantë e zhvillimit të qëndrueshëm.

Në një kontekst global të shënuar nga tranzicioni energjetik, pasiguritë ushqimore dhe rikonfigurimi i zinxhirëve të furnizimit, përvoja kineze e zhvillimit rural paraqet hapësira konkrete reflektimi edhe për Europën dhe vendet e Ballkanit Perëndimor. Ideja e

përbashkët është që përvoja kineze mund të ofrojë modele të adaptueshme për Europën dhe Shqipërinë.

Për Bashkimin European, i cili po përballet me sfida të plakjes së popullsisë rurale, fragmentimit të tokës dhe tranzicionit të gjelbër, modeli kinez i integritit të teknologjisë, planifikimit territorial dhe zhvillimit të zinxhirëve të vlerës ofron një rast studimi mbi mënyrën sesi modernizimi bujqësor mund të kombinohet me stabilitet social dhe siguri ushqimore.

Për Shqipërinë, si vend me strukturë territoriale dhe demografike ku zonat rurale zënë një peshë të rëndësishme, bashkëpunimi me Kinën mund të eksplorohet në disa drejtime strategjike: transferim teknologjie në bujqësi inteligjente; investime në përpunimin agro-industrial; energji të rinovueshme në zona rurale dhe shkëmbim eksperimentesh në planifikimin territorial dhe zhvillimin e “fshatrave model”.

Në një qasje pragmatike dhe të balancuar, bashkëpunimi mund të ndërtohet mbi interesa reciproke ekonomike, duke respektuar kornizat rregullatore europiane dhe prioritetet kombëtare të zhvillimit.

Natyrisht, çdo bashkëpunim duhet të zhvillohet në përputhje me standardet dhe kornizat rregullatore të Bashkimit European, duke garantuar transparencë dhe përputhshmëri me procesin e integritit european të Shqipërisë.

Në këtë mënyrë, zhvillimi rural nuk mbetet thjesht një çështje e brendshme kineze, por shndërrohet në një platformë dialogu ekonomik dhe teknologjik ndërmjet Azisë dhe Europës, ku Shqipëria mund të pozicionohet si urë bashkëpunimi.

Zarzavatet kthehen në mall luksi, pse po na kushtojnë kaq shtrenjtë

Mungesa e prodhimit vendas dhe dëmet nga moti kanë reduktuar ndjeshëm ofertën e produkteve vendase në treg, duke bërë që çmimet të fluturojnë mbi 300-400 lekë për kilogram për prodhimet e stinës si brokoli dhe spinaqi, gati 30% më shumë se vjet në këtë periudhë, sipas të dhënave nga tregu. Zinxhiri i gjatë i ndërmjetësve bën që çmimi nga fusha në tryezë të rritet me mbi 100% në shumë raste. Importet hyjnë me çmime konkurruese, duke dekurajuar më tej prodhimin vendas. Tirana dhe zonat periferike si Gjirokastra po përballen me çmimet më të larta. Pa investime në pikat e grumbullimit dhe një funksionim etik të zinxhirit të furnizimit, prodhimi vendas dhe konsumatori shqiptar do të jenë të ekspozuar nga rreziqet e importit. Kush po penalizohet më shumë nga barra e kostove?

Mungesa e prodhimit vendas, dëmet e krijuara nga përmbytjet dhe varësia nga importet kanë vënë konsumatorët në të gjithë vendin përballë çmimeve të papërbalueshme dhe shumë më të larta se vitin e kaluar, kryesisht për zarzavatet gjatë këtij muaji.

Produktet e serrës si specat 400 lekë/kg në pakicë, spinaqi

me 300 lekë dhe patëllxhanët e importit me 400 lekë/kg po shndërrohen në artikuj luksi, duke detyruar familjet me të ardhura të ulëta të orientojnë konsumin drejt alternativave më të lira.

Një vëzhgim i detajuar i çmimeve me shumicë nga Portali i Fermerit dhe të dhënat nga tregjet e pakicës, tregojnë

për marzh të lartë spekulimi që kalon edhe 100% të vlerës së produktit nga pikat e pakicës në Fier, Divjakë dhe Lushnjë deri në tregjet e pakicës në kryeqytet.

Situata është edhe më e vështirë në qarqet më periferike dhe me popullsi të plakur si Gjirokastra, ku çmimet e zarzavateve aktualisht janë më të sh-

trenjtat në të gjithë vendin.

Gëzimi me përvojë gati 30-vjeçare, si shitës me pakicë frutash dhe perimesh tek Uzina Dinamo në Tiranë, pohon se për disa prodhime si spinaqi, patëllxhani, kungulli, brokoli, çmimet janë më të larta se vitin e kaluar në këtë periudhë. “Spinaqi dhe brokoli i vendit u dëmtuan nga përmbytjet dhe

ngricat e dimrit, ndërsa kungulli, patëllxhani, domatet, karotat dhe shumë të tjera po vijnë nga importi me çmime më të larta”, pohoi tregtari.

Prodhimi vendas po humbet terren me shpejtësi përballë importit. Raftet e marketeve dhe tezgave ndajnë hapësirën në favor të importeve. Të dhënat e INSTAT tregojnë se në vitin 2025,

sasia e zarzavateve të importuara u rrit me 14% në krahasim me 2024, ndërsa në harkun e 5 viteve janë dyfishuar.

Domatja e serrës dhe trangujt importohen me rreth 194-220 lekë për kg, teksa fermeri vendas, që shpesh e shet domaten me 130 lekë në shumicë, nuk

INFLACION

Zarzavatet kthehen në mall luksi, pse po na kushtojnë kaq shtrenjtë

(Vijon nga faqja 11)

ka fuqi të konkurrojë me qëndrueshmëri dhe standardizimin e produkteve të huaja.

Frutat po ndjekin të njëjtin trend ku dardha dhe hurma me çmim shumice 210 lekë dominojnë raftet, ndërsa prodhimi vendas mbetet i fragmentuar dhe pa mbështetje logjistike.

Kjo varësi nga jashtë dhe keqfunksionimi i zinxhirëve të furnizimit po ekspozon qytetarët e Tiranës ndaj çmimeve më të larta, duke paguar më shtrenjtë se në shumë kryeqytete të rajonit.

Nga ngastra te tezgat, çmimet fluturojnë

Konsumatorët e Tiranës shpesh paguajnë dyfishin ose trefishin e vlerës reale të produktit që prodhohet në një distancë më pak se 90 kilometra, ndërkohë që zinxhiri i ndërmjetësve duket se përfiton pjesën më të madhe të marzhit. Kjo vlen edhe për produktet që vijnë nga importi.

Në krye të listës së produkteve me rritjen më agresive qëndrojnë perimet e serrës dhe ato të sezonit. Specat dhe patëllxhanët, të cilët në shumicë tregtohen rreth 210-265 lekë, në dyqanet e pakicës arrijnë deri në 400 lekë për kilogram.

Ky kërcim prej gati 90% tregon paqëndrueshmëri që prek drejtpërdrejt konsumatorët. Edhe domatja e serrës, një element i pandashëm i tryezës shqiptare, shfaq një anomali: ndërsa në shumicë kushton 130 lekë dhe 194 lekë, në pakicë ajo mund të shkojë deri në 280-300 lekë, duke reflektuar një marzh shumë të lartë të zinxhirit të furnizimit.

Fasulja, brokoli dhe spinaqi kryesojnë rritjen

Fasulja, një nga produktet mjaft popullore në recetat tona, mban rekordin e çmimit në tregun e pakicës, duke u shitur deri në 700 lekë për kilogram këto ditë.

Fasulja e vendit me pakicë luhet në 400 lekë për kilogram, ndërsa importi është edhe më i lirë me vetëm 180 lekë për kilogram, gjë që ngre pyetje të forta mbi strukturën e tregtimit dhe arsyet pse ky produkt bazë pëson një rritje kaq galopante në zinxhirin të furnizimit.

Po ashtu, brokoli dhe spinaqi i fushës shfaqin të njëjtin tendencë, ku diferenca mes çmimit të grumbullimit dhe shitjes finale mbetet e lartë, duke e bërë ushqyerjen e shëndetshme gjithnjë e më të papërbalueshme.

Një kilogram spinaq fushë u shit me shumicë, sipas të dhënave nga Portali i Fermerit, më 6 shkurt me 160 lekë për kilogram, ndërsa me pakicë, çmimi arriti në të njëjtin ditë në kryeqytet në 300 lekë/kg. Brokoli gjithashtu nga 190 lekë me shumicë shitet rreth 250-300 lekë me pakicë në tregjet e Tiranës në të njëjtin ditë.

Frutat mes prodhimit vendas dhe varësisë nga importi

Në sektorin e frutave, situata duket disi më e balancuar, por përsëri e ndjeshme ndaj origjinës së produktit. Portokajtë dhe mollët mbeten shpëtimi i fundit për xhepat e qytetarëve, me çmime që nisin nga 80 deri në 150 lekë në pakicë.

Megjithatë, frutat si dardha dhe hurma janë pothuajse tërësisht të varura nga importi, me çmime grumbullimi prej 210 lekësh që përkthehen në 300 lekë për konsumatorin. Kjo tregon se pa një mbështetje më të fortë për frutikulturën vendase, konsumatori do të mbetet peng i çmimeve të diktuar nga tregjet e huaja dhe kostot e transportit.

Produktet e "varfra" që po shtrenjtohen

Edhe ato që historikisht njihen si produkte të lira, si patatja dhe qepa, nuk po i shpëtojnë trendit rritës. Me një çmim shumice prej 40 lekësh, ato arrijnë në 80 lekë në pakicë.

Ndonëse shifrat duket të ulëta në vlerë absolute, në përqindje rritja prej 100% është një goditje e fortë për familjet me të ardhura minimale që mbështeten kryesisht te këto produkte për mbijetesë.

Të dhënat dëshmojnë se tregu i Tiranës po vuan nga një mungesë e efikasitetit në shpërndarje. Ndërsa fermerët dhe grumbulluesit operojnë me çmime relativisht të ulëta, "shkallët" e shumta që kalon produkti deri te blerësi final po krijojnë një fryrje artificiale të kostove, duke e kthyer shportën bazë në një sfidë muje për shumë qytetarë.

Nga prodhuesi tek tregu: kush fiton?

Marzhet e fitimeve nga fusha e prodhimit deri te qesja e konsumatorit zbulojnë një mekanizëm spekulativ, ku vlera e produktit rritet në mënyrë disproporcionale në çdo hallkë të zinxhirit.

Ky rrugëtim nis me fermerin, i cili mban peshën më të madhe të punës dhe rrezikut, por shpesh merr pjesën më të vogël të tortës financiare.

"Në të gjithë zinxhirin e ushqimit, ne jemi më të penalizuar. Shpesh punojmë me humbje dhe jemi të ekspozuar para çmimeve të shitjes pa asnjë mbrojtje.

Këtë vit u dëmtuam tërësisht nga përmblytjet. Ndërkohë që ne shesim një kilogram domate në fermë 80 ose 90 lekë për kg, në Tiranë i njëjti prodhim shitet deri në dyfish më shumë", tha Mirlind Saraçi, një fermer që kultivon perime në serra në zonën e Beratit.

Për produkte si patatja apo qepa, që në shumicë tregtohen me 40 lekë, prodhuesi detyrohet të shesë me çmime që mezi mbulojnë koston e farës, plehrave dhe naftës, duke mbetur me një fitim minimal që rrallë i kalon 5 deri në 10 lekë për kilogram.

Ky pozicion i pafavorshëm vjen si pasojë e mungesës së fuqisë negociuese dhe pamundësisë për të mbajtur produktin gjatë në magazinë.

Sapo produkti largohet nga dora e fermerit, ai kalon në hallkën e grumbulluesit dhe tregut të shumicës, ku çmimi pëson fryrjen e parë të ndjeshme. Në këtë fazë, marzhi nuk përfaqëson vetëm fitimin, por edhe kostot e pashmangshme të logjistikës, si transporti, ambalazhimi dhe humbjet natyrale gjatë peshimit.

Rasti i fasules është shembulli më flagrant i këtij tranzicioni, ku diferenca mes çmimit të importit prej 180 lekësh dhe çmimit të shumicës prej 400 lekësh tregon se ndërmjetësi e mëdhenj aplikojnë marzhe që i kalojnë 100%.

Kjo ndodh sepse ata kontrollojnë ofertën dhe kanë kapacitete frigoriferike, duke diktuar ritmin e tregut përpara se produkti të shpërndahet te shitësit e vegjël.

Goditja përfundimtare për xhepin e qytetarit vjen në hallkën e fundit: pakica. Dyqanet e lagjeve dhe tezgat e tregjeve të vogla aplikojnë marzhet më agresive, të cilat shpesh kalojnë dyfishin e çmimit me të cilin e kanë blerë produktin në shumicë.

Një tregtar pakice që blen lakër me 28 lekë dhe e shet atë me 80 lekë, e justifikon këtë rritje me qiranë e lartë të dyqanit, faturat e energjisë dhe faktin që një pjesë e mirë e perimeve dëmtohen e hidhen në mbeturina.

Megjithatë, kjo strukturë bën që konsumatori fundor në Tiranë të paguajë për të gjitha problemet e sistemit, duke e kthyer një produkt që kushton pak në origjinë, në një kosto të rëndë për jetesën e përditshme.

Fieri, Lushnja dhe Divjaka, me çmimet më të lira

Analiza e tregut të shumicës në Shqipëri për muajin shkurt 2026, mbështetur në databazën e çmimeve të përditësuar në Portalin e Fermerit, tregon vështirësitë që sjell sezoni i dimrit për bujqësinë vendase.

Tregu paraqitet me dy shpejtësi: nga njëra anë janë produktet si patatja dhe lakra, prodhimet vendase të stinës, të cilat ruajnë çmime mjaft të ulëta në të gjitha qytetet; dhe nga ana tjetër janë perimet jeshile dhe ato të serrës, tërësisht jashtë çdo logjike për fuqinë blerëse të shumicës së konsumatorëve shqiptarë.

Të dhënat tregojnë se Divjaka dhe Fieri vazhdojnë të luajnë rolin e rregullatorit të çmimeve në rang kombëtar. Dominimi i tyre në prodhimin e lakrës 22 lekë për kg dhe patates 35 lekë për kg po mban çmimet e këtyre produkteve afërsisht 50% më të ulëta se në skajet e vendit si Gjirokastra.

Megjithatë, vihet re se edhe brenda këtyre zonave, produkte si spinaqi apo trangulli i serës mbeten të shtrenjtë, çka dësh-

mon se presioni i kostove të prodhimit është i pranishëm kudo.

Tirana dhe Gjirokastra, me më të shtrenjtat

Tregu i Tiranës dhe Gjirokastrës shfaq vlerat më të larta, sidomos te produktet e importit dhe disa lloje zarzavatesh që nuk prodhohen në këtë rajon. Spinaqi në kryeqytet po shitet me 300 lekë për kg, 30% më shumë se vitin e kaluar për shkak të dëmit që iu krijua prodhimit vendas nga përmblytjet e janarit.

Po ashtu, specat në Gjirokastër arrijnë vlerën rekord prej 350 lekësh për kilogram, që tregon se zonat larg qendrave të prodhimit varen tërësisht nga logjistika dhe produkti i huaj.

Një fenomen interesant vihet re në Korçë, ku domatja e importit ka zëvendësuar plotësisht atë vendase me një çmim rreth 300 lekë për kilogram, ndërsa frutat si molla mbeten më të lirë në vend (65 lekë/kg). Korça furnizon vendin me mollë, ndërsa vetë importon perimet bazë të serrës.

Në tërësi, tregu shqiptar në këtë periudhë diktohet nga gjeografia e prodhimit, ku sa më larg zonës së Myzeqesë të lëvizet produkti, aq më shumë shtohet kostoja për shkak të ndërmjetësve dhe transportit, duke krijuar diferenca çmimesh që shpesh tejkalojnë logjikën e thjeshtë të tregtisë.

